Vendim nr. 308, datë 30.09.2026

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Marsida Xhaferllari,	Kryesuese
Genti Ibrahimi,	Anëtar
Ilir Toska,	Anëtar

në datën 30.09.2026 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 17 (S) 2026 të Regjistrit Themeltar, që i përket:

KËRKUES: **SOKOL HASANI**

OBJEKTI: **Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2024-2046, datë 15.05.2024 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.**
Konstatimi i cenimit të së drejtës kushtetuese për proces të rregullt ligjor dhe akses efektiv në gjykatë.
Dërgimi i çështjes për rishqyrtim në përputhje me standardet kushtetuese dhe ato të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

BAZA LIGJORE: **Nenet 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pika 1, shkronja "i", të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); nenet 27 e vijuese të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar (*Ligji Organik i Gjykatës*).**

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoi relatorin e çështjes Ilir Toska, shqyrtoi kërkesën dhe dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesi Sokol Hasani, duke pretenduar se gjatë procedurës së pajisjes me pasaportë biometrike i janë krijuar pengesa të paligjshme, të cilat i kanë shkaktuar dëme materiale dhe morale, të lidhura me humbjen e shumave të parapaguara për rezervimin e biletave të udhëtimit, pamundësinë për të qenë i pranishëm si përfaqësues ligjor në disa çështje jashtë Shqipërisë, përfshirë Italinë, ku ka të drejtë të ushtrojë profesionin e avokatit, si dhe cenimin e integritetit psikik, nderit e personalitetit, i është drejtuar gjykatës me padi kundër shoqërisë "ALEAT" sh.p.k., ministrit të Brendshëm S.T. dhe kryeministrit E.R. Me padinë e tij kërkuesi ka kërkuar detyrimin e të padituve për shpërblimin e dëmit në shumën 5.000.000 euro, si dhe dorëzimin e pasaportës biometrike, për të cilën kishte kryer pagesën, në përputhje me legjislacionin e zbatueshëm.

2. Në seancën përgatitore përpara Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, përfaqësuesja e kërkuesit ka kërkuar përjashtimin e tij nga pagimi i tarifës gjyqësore, në bazë të nenit 158/a të Kodit të Procedurës Civile (*KPC*), duke pretenduar se paditësi është në pamundësi objektive për pagimin e kësaj shume dhe se detyrimi për ta paguar atë do ta privonte nga e drejta kushtetuese e aksesit në gjykatë. Kjo kërkesë është rrëzuar nga gjykata, me arsyetimin se neni 158/a, pika 2, i KPC-së parashikon mundësinë e përjashtimit nga pagimi i tarifave gjyqësore vetëm në rastet e përcaktuara shprehimisht me ligj, ndërkohë që kërkuesi nuk kishte identifikuar ndonjë dispozitë ligjore konkrete që e përjashton nga ky detyrim dhe as kishte paraqitur prova që vërtetojnë se ai bën pjesë në kategorinë e subjekteve që përjashtohen me ligj nga pagimi i taksave.

3. Në vijim, bazuar në nenin 154/a të KPC-së, gjykata e shkallës së parë ka vendosur lënien e padisë pa veprime, duke i caktuar kërkuesit një afat për plotësimin e kësaj të mete. Pas kalimit të këtij afati, në seancën përgatitore të datës 16.03.2015, përfaqësuesja e kërkuesit ka deklaruar se tarifa gjyqësore nuk ishte paguar, duke pretenduar se shuma e kërkuar ishte e papërballueshme për një nëpunës me të ardhura normale. Ajo ka përsëritur kërkesën për përjashtimin e kërkuesit nga ky detyrim, me argumentin se pamundësia ekonomike për të paguar taksën mbi aktet nuk mund ta privojë atë nga e drejta e aksesit në gjykatë. Në këtë situatë, gjykata, me vendimin nr. 2034, datë 16.03.2015, duke konstatuar se kërkuesi nuk kishte plotësuar brenda afatit të caktuar të metat e padisë, ka vendosur kthimin e saj së bashku me aktet e tjera, me arsyetimin se nuk ishin

përmbushur të gjitha kërkesat ligjore për marrjen e saj në shqyrtim, sipas nenit 154 të KPC-së. Sipas gjykatës, nga verifikimi i akteve të paraqitura rezultonte se kërkuesi nuk kishte paguar taksën mbi aktet (tarifën gjyqësore), në kundërshtim me përcaktimet e nenit 156, pika 2, të KPC-së. Kjo taksë, sipas Udhëzimit të Përbashkët nr. 5668, datë 20.11.2013, të ministrit të Drejtësisë dhe ministrit të Financave (*Udhëzimi i Përbashkët nr. 5668/2013*), ishte në masën 50.000 euro, që përfaqësonte 1% të vlerës së padisë. Kundër këtij vendimi kërkuesi ka paraqitur ankim të veçantë.

4. Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 426, datë 06.10.2015, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Sipas saj, kërkuesi nuk ka identifikuar ndonjë dispozitë ligjore që e përjashtonte nga detyrimi për pagimin e taksës mbi aktet dhe as ka paraqitur prova që vërtetojnë se ai bën pjesë në kategoritë e subjekteve të përjashtuara me ligj nga ky detyrim. Gjykata e apelit ka vlerësuar se, në bazë të neneve 102 e vijues të KPC-së, çdo individ që i drejtohet gjykatës me padi ka detyrimin të parapaguajë taksën mbi aktet, në masën e përcaktuar me ligj. Pagesa e kësaj takse përbën një kërkesë të detyrueshme procedurale, pa përmbushjen e së cilës nuk mund të vijojë shqyrtimi i padisë, ndërsa dokumenti që vërteton kryerjen e saj duhet të paraqitet së bashku me padinë, sipas nenit 156 të KPC-së. Në vlerësimin e gjykatës së apelit, gjatë gjykimit ka rezultuar se kërkuesi nuk bënte pjesë në kategoritë e subjekteve të përjashtuara nga pagimi i taksës, të përcaktuara në ligjin nr. 9975, datë 28.07.2008 "Për taksat kombëtare", të ndryshuar, të cilat, sipas asaj gjykate, përkojnë me kategoritë e përfituesve të ndihmës juridike falas, sipas ligjit nr. 10039, datë 22.12.2008 "Për ndihmën juridike" (*Ligji për Ndihmën Juridike*). Kundër këtij vendimi kërkuesi ka paraqitur rekurs.

5. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2024-2046, datë 15.05.2024, ka vendosur mospranimin e rekursit të kërkuesit, me arsyetimin se ai është bërë për shkaqe të ndryshme nga ato të parashikuara në nenin 472 të KPC-së. Sipas atij kolegji, gjykata e apelit ka respektuar ligjin procedural dhe atë material, duke i interpretuar dhe zbatuar drejt ato, ndërsa vendimi i saj nuk bie në kundërshtim me ndonjë vendim të Kolegjit Civil ose të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë. Po ashtu, ai kolegj ka vlerësuar se nuk konstatohen shkelje të rënda të normave procedurale, me pasojë pavlefshmërinë e vendimit ose të procedurave të gjykimit.

6. Në datën 19.06.2026 kërkuesi ka paraqitur ankim kushtetues individual në Gjykatën Kushtetuese (*Gjykata*), sipas objektit të tij. Ky ankim, pasi është plotësuar në përputhje me

parashikimet e nenit 27 të Ligjit Organik të Gjykatës, është regjistruar në datën 02.07.2026. Në lidhje me afatin për shqyrtimin paraprak të çështjes, të përcaktuar në nenin 47, pika 1, të Ligjit Organik të Gjykatës, bazuar në nenet 15, pika 2 dhe 21, pika 1, të Rregullores për Procedurat Gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese, në këtë afat nuk llogaritet periudha e lejes vjetore, sipas nenit 18, pika 1, shkronja "b", të po këtij ligji.

II

Pretendimet e kërkuesit

7. ***Kërkuesi,*** në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se është cenuar:

7.1. *E drejta për proces të rregullt,* në drejtim të:

7.1.1. *Së drejtës së aksesit në gjykatë*, pasi padia e tij nuk u shqyrtua në themel dhe procesi përfundoi për shkaqe ekskluzivisht formale, të lidhura me mospagimin e tarifës gjyqësore. Refuzimi për shqyrtimin e padisë për shkak të detyrimit për pagimin e tarifës prej 50.000 eurosh ka përbërë një kufizim real për aksesin në gjykatë, pasi kjo shumë ishte objektivisht e papërballueshme për të. Gjykatat nuk kanë vlerësuar rëndësinë e së drejtës së pretenduar, natyrën e interesit të mbrojtur, mundësinë e përdorimit të mjeteve më pak kufizuese, si dhe domosdoshmërinë dhe proporcionalitetin e kufizimit në përputhje me kriteret e nenit 17 të Kushtetutës. Për rrjedhojë, kufizimi i së drejtës së aksesit në gjykatë ka pasur efekt ndalues absolut dhe ka qenë joproporcional.

7.1.2. *Standardit të arsyetimit të vendimit,* pasi Gjykata e Lartë është mjaftuar me konstatimin se rekursi nuk përmban shkaqet e parashikuara në nenin 472 të KPC-së, pa analizuar argumentet me natyrë kushtetuese të parashtruara në të, që lidhen me cenimin e së drejtës së aksesit në gjykatë, lirinë e lëvizjes, parimin e hierarkisë së normave dhe proporcionalitetin e ndërhyrjes.

7.1.3. *Parimit të sigurisë juridike,* pasi publikimi i vendimit të Gjykatës së Lartë në internet nuk mund të zëvendësojë njoftimin individual të tij. Interpretimi i publikimit si mënyrë e mjaftueshme njoftimi zhvendos barrën e njoftimit nga autoritetet shtetërore tek individi. Kërkuesi është vënë në dijeni për vendimin e Gjykatës së Lartë në mënyrë informale në datën 07.05.2026. Ndonëse ai i ka

kërkuar asaj gjykate informacion dhe prova për kryerjen e njoftimit, në përgjigjen e saj nuk është paraqitur ndonjë provë që të vërtetojë njoftimin individual. Për rrjedhojë, publikimi i vendimit në faqen zyrtare në internet nuk përbën njoftim efektiv, ndërsa individi nuk ka detyrimin të ndjekë publikimet në internet për t'u njohur me vendimet gjyqësore.

7.1.4. *Së drejtës për një mjet juridik efektiv,* pasi mosshqyrtimi në themel i pretendimeve me natyrë kushtetuese dhe mungesa e njoftimit efektiv të vendimit të Gjykatës së Lartë e kanë bërë iluzore mbrojtjen gjyqësore të të drejtave të kërkuesit.

7.2. *Parimit të hierarkisë së normave dhe të lirisë së lëvizjes,* pasi kufizimi i së drejtës së kërkuesit për të lëvizur lirisht nuk mbështetet në ligj, por në akte nënligjore dhe praktika administrative, të cilat nuk mund të përbëjnë bazë të mjaftueshme për kufizimin e të drejtave themelore.

III
Vlerësimi i Kolegjit

A. Për kriteret e pranueshmërisë së kërkesës

8. Gjykimi kushtetues mund të vihet në lëvizje vetëm nëse përmbushen kriteret paraprake të pranueshmërisë së kërkesës, të parashikuara nga Kushtetuta dhe Ligji Organik i Gjykatës. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja "f", dhe 134, pikat 1, shkronja "i" dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të Ligjit Organik të Gjykatës, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private ose publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret kumulative të parashikuara nga neni 71/a i Ligjit Organik të Gjykatës, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuara në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

9. Kriteret paraprake të pranueshmërisë së kërkesës janë të natyrës kumulative, ndaj mosplotësimi qoftë edhe i njërit prej tyre mjafton për të penguar kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare dhe e bën të panevojshëm verifikimin e kritereve të tjera. Gjatë shqyrtimit

paraprak Kolegji mund të verifikojë një ose më shumë prej këtyre kritereve, pa qenë i detyruar të ndjekë një radhë të paracaktuar të analizës. Në këtë drejtim, Kolegji vëren se pretendimi për mosnjoftimin e vendimit të Gjykatës së Lartë, përfshirë aspektin e së drejtës për një mjet juridik efektiv që lidhet me këtë njoftim, ka të bëjë me momentin e marrjes dijeni për vendimin dhe, për rrjedhojë, me respektimin e afatit për paraqitjen e ankimit kushtetues individual. Megjithatë, duke pasur parasysh natyrën kumulative të kritereve të pranueshmërisë, Kolegji do të shqyrtojë fillimisht plotësimin e kriterit *ratione materiae* për pretendimet e kërkuesit që lidhen me vendimet e gjykatave të zakonshme dhe, në vijim, do të vlerësojë plotësimin e kriterit të *shterimit të mjeteve juridike efektive* për pretendimet që lidhen me themelin e mosmarrëveshjes civile, duke e vlerësuar të panevojshëm shqyrtimin e kriterit të afatit ligjor (*ratione temporis*) nëse rezulton se kërkesa nuk plotëson kriteret e tjera të pranueshmërisë.

10. Kolegji vëren, fillimisht, se objekt i ankimit kushtetues individual është vendimi i Gjykatës së Lartë, me të cilin është vendosur mospranimi i rekursit të kërkuesit, ndërsa pretendimet e tij lidhen edhe me vendimin e gjykatës së shkallës së parë për kthimin e padisë dhe vendimin e gjykatës së apelit që e ka lënë atë në fuqi. Në ankimin e tij kërkuesi ka pretenduar cenimin e *së drejtës për proces të rregullt ligjor* në drejtim të *së drejtës së aksesit* dhe *standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor*. Po ashtu, kërkuesi ka pretenduar edhe cenimin e *parimit të hierarkisë së normave* dhe të *lirisë së lëvizjes*.

11. Për sa u përket pretendimeve për cenimin e *së drejtës së aksesit në gjykatë* dhe *të standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor,* Kolegji vëren se ato lidhen drejtpërdrejt me vendimet gjyqësore të kundërshtuara. Pavarësisht mënyrës së parashtrimit të tyre, këto pretendime, në thelb, kanë të bëjnë me cenimin e *së drejtës së aksesit në gjykatë*, për shkak të detyrimit për pagimin e tarifës gjyqësore prej 50.000 eurosh, të cilën kërkuesi e konsideron të papërballueshme dhe si pengesë absolute për shqyrtimin e padisë së tij. Në këtë kuadër, Kolegji do të vlerësojë edhe pretendimin për cenimin e së drejtës për një mjet juridik efektiv, për aq sa ai mbështetet në mosshqyrtimin në themel të padisë së kërkuesit. Për rrjedhojë, Kolegji do t'i analizojë këto pretendime së bashku, në kuadër të së *drejtës së aksesit në gjykatë.*

12. Gjykata ka theksuar se e drejta e aksesit, si një nga aspektet e së drejtës për proces të rregullt ligjor, u garanton subjekteve që pretendojnë cenimin e një të drejte mundësinë t'i drejtohen një gjykate, e cila duhet të dëgjojë pretendimet e tyre dhe të shpallë një vendim pas një gjykimi të

drejtë dhe publik. Kjo e drejtë nuk kufizohet vetëm në fillimin formal të procesit, por përfshin edhe të drejtën për të pasur, nga ana e gjykatës, një zgjidhje përfundimtare për çështjen, pasi aksesi në gjykatë duhet të jetë substantiv dhe jo thjesht formal *(shih vendimet nr. 73, datë 16.06.2026; nr. 22, datë 29.04.2021; nr. 3, datë 23.02.2016 të Gjykatës Kushtetuese)*.

13. Po ashtu, Gjykata ka pohuar se e drejta e aksesit në gjykatë nuk është absolute dhe mund t'u nënshtrohet kufizimeve që lidhen, ndër të tjera, me respektimin e kërkesave procedurale të përcaktuara nga Kushtetuta dhe ligji. Megjithatë, këto kufizime nuk duhet të cenojnë vetë thelbin e së drejtës së aksesit, ato duhet të ndjekin një qëllim legjitim dhe ndërmjet mjeteve të përdorura dhe qëllimit të synuar duhet të ekzistojë një marrëdhënie e arsyeshme proporcionaliteti. Në këtë kuptim, mënyra e interpretimit dhe zbatimit të kërkesave procedurale duhet të ruajë një balancë të drejtë ndërmjet respektimit të tyre, në funksion të sigurisë juridike dhe administrimit të mirë të drejtësisë, nga njëra anë, dhe së drejtës së individit për akses efektiv në gjykatë, nga ana tjetër, pa i imponuar atij një barrë joproporcionale (*shih vendimet nr. 34, datë 12.06.2023; nr. 23, datë 25.04.2023 të Gjykatës Kushtetuese*). Në këtë drejtim, kërkesat procedurale nuk duhet të interpretohen ose zbatohen me një formalizëm të tepruar, në mënyrë që një rregull procedural garantues të shndërrohet në pengesë për ushtrimin efektiv të së drejtës së aksesit *(shih vendimet nr. 2, datë 21.01.2025; nr. 80, datë 21.11.2024; nr. 37, datë 05.11.2021 të Gjykatës Kushtetuese).*

14. Në lidhje me detyrimin për pagimin e tarifave gjyqësore, Gjykata ka theksuar se ky detyrim nuk përbën, në vetvete, pengesë për ushtrimin e së drejtës së aksesit në gjykatë. Sipas Gjykatës, çdo individ që i drejtohet gjykatës me padi ka detyrimin të parapaguajë taksën mbi aktet (tarifën për shërbime gjyqësore), e cila caktohet mbi bazën e vlerës së padisë. Megjithatë, gjyqtari i zakonshëm nuk pengohet të hetojë dhe të përjashtojë paditësin nga pagimi i kësaj tarife, kur ai ndodhet në pamundësi financiare për përmbushjen e këtij detyrimi. Në këtë drejtim, gjyqtari ka hapësirë për të vlerësuar plotësimin e këtij kriteri procedural dhe për të vendosur, rast pas rasti, përjashtimin nga pagimi i tarifës, në mënyrë që të mos pengohet realizimi i së drejtës së aksesit në gjykatë. Gjykata ka theksuar, gjithashtu, se i takon gjyqtarit të hetojë, mbi bazën e dokumentacionit provues të pamundësisë ekonomike të paraqitur nga paditësi, dhe të vlerësojë, duke iu referuar legjislacionit procedural civil dhe rregullimeve ligjore përkatëse, nëse është rasti për përjashtimin e paditësit nga pagesa e tarifës për shërbime gjyqësore (*shih vendimin nr. 7, datë 27.02.2013 të Gjykatës Kushtetuese*).

15. Nga ana tjetër, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*GJEDNJ*) ka theksuar se e drejta e aksesit në gjykatë nuk është absolute, por mund të bëhet objekt i kufizimeve, pasi për nga vetë natyra e saj kërkon rregullimin nga ana e shtetit, rregullim i cili mund të variojë në kohë dhe në vend, në varësi të nevojave dhe burimeve të komunitetit dhe të individëve. Megjithatë, kufizimet nuk duhet të cenojnë vetë thelbin e kësaj të drejte, duhet të ndjekin një qëllim legjitim dhe ndërmjet mjeteve të përdorura dhe qëllimit të synuar duhet të ekzistojë një marrëdhënie e arsyeshme proporcionaliteti. Në lidhje me tarifat gjyqësore, GJEDNJ-ja ka vlerësuar se kërkesa për pagimin e tyre në gjykatat civile, për paditë për të cilat ato duhet të japin një vendim, nuk përbën *per se* kufizim të papajtueshëm me nenin 6, paragrafi 1, të Konventës. Megjithatë, masa e tarifës, e vlerësuar në dritën e rrethanave konkrete të çështjes, përfshirë aftësinë financiare të kërkuesit për ta paguar atë, si dhe faza e procesit në të cilën vendoset ky kufizim, janë faktorë me rëndësi për përcaktimin nëse është respektuar e drejta e aksesit në gjykatë. Kufizimet me natyrë thjesht financiare, që nuk lidhen me meritat e padisë ose me perspektivat për suksesin e saj, kërkojnë një shqyrtim veçanërisht rigoroz nga pikëpamja e interesave të drejtësisë (*shih Laçi kundër Shqipërisë, datë 19.10.2021, §§ 50, 51*).

16. Po ashtu, GJEDNJ-ja ka konsideruar të tepruara dhe cenuese të vetë thelbit të së drejtës për akses në gjykatë tarifat e larta gjyqësore, të cilat nuk justifikoheshin nga gjendja financiare e kërkuesit, por ishin përllogaritur mbi bazën e një përqindjeje standarde statutore të vlerës së padisë. Nga ana tjetër, ajo ka theksuar se pala që kërkon të përjashtohet nga pagimi i tarifave gjyqësore duhet të veprojë me kujdesin e nevojshëm në paraqitjen e provave për gjendjen e saj financiare dhe ka detyrimin të bashkëpunojë në mirëbesim me gjykatën (*shih Laçi kundër Shqipërisë, datë 19.10.2021, §§ 52, 55*).

17. GJEDNJ-ja ka pasur rastin të shqyrtojë kuadrin ligjor shqiptar për tarifat gjyqësore, të zbatueshëm edhe në periudhën së cilës i përket çështja në shqyrtim. Në këtë drejtim, ajo ka vënë në dukje se legjislacioni vendas kërkonte pagimin e taksës mbi aktet, të llogaritur në bazë të një përqindjeje standarde, të përcaktuar nga ligji, për shumën e pretenduar në padi. GJEDNJ-ja nuk ka përjashtuar mundësinë që qëllimi i ndjekur nga rregullat e përgjithshme për pagimin dhe mbledhjen e tarifave gjyqësore t'i shërbejë interesit të drejtësisë dhe, si i tillë, të konsiderohet në përputhje me jurisprudencën e saj (*shih Laçi kundër Shqipërisë, datë 19.10.2021, § 53*).

18. Për sa i përket kuadrit ligjor në fuqi në kohën e paraqitjes së padisë nga kërkuesi, Kolegji vëren se nenet 102 dhe 156 të KPC-së parashikonin detyrimin për pagimin e taksës mbi aktet në momentin e paraqitjes së kërkesëpadisë, ndërsa neni 154/a përcaktonte pasojat procedurale të mosplotësimit të këtij detyrimi. Nga ana tjetër, neni 158/a i KPC-së parashikonte mundësinë e përjashtimit të paditësit nga pagimi i taksës mbi aktet në rastet e përcaktuara me ligj. Po kështu, Ligji për Ndihmën Juridike parashikonte përjashtimin nga pagimi i taksës mbi aktet dhe i shpenzimeve gjyqësore si një nga format e ndihmës juridike, si dhe kushtet për përfitimin e saj. Sipas nenit 21/1 të këtij ligji, kërkesa për përjashtim shqyrtohej nga Komisioni Shtetëror për Ndihmën Juridike, ndërsa, në rast të mosmarrjes së vendimit ose të rrëzimit të kërkesës nga ky komision, gjykata mund të vendoste përjashtimin gjatë veprimeve përgatitore, nëse përmbusheshin kushtet ligjore përkatëse. Po kështu, ligji parashikonte mundësinë e shtyrjes së pagimit të taksës ose të kryerjes së saj me këste, sipas kushteve të përcaktuara në të.

19. Në rastin konkret, Kolegji vëren se kërkuesi ka paraqitur padi me objekt shpërblimin e dëmit në shumën 5.000.000 euro, për shkak të veprimeve të pretenduara të paligjshme gjatë procedurës së pajisjes së tij me pasaportë biometrike. Në zbatim të kuadrit ligjor të sipërcituar dhe të Udhëzimit të Përbashkët nr. 5668/2013, tarifa gjyqësore që kërkuesi duhej të paguante ishte në masën 50.000 euro, që përfaqësonte 1% të vlerës së padisë.

20. Kolegji vëren se përfaqësuesja e kërkuesit ka kërkuar përjashtimin e tij nga pagimi i tarifës gjyqësore, duke pretenduar se shuma prej 50.000 eurosh ishte objektivisht e papërballueshme për një nëpunës me të ardhura normale dhe se detyrimi për pagimin e saj do ta privonte kërkuesin nga e drejta e aksesit në gjykatë. Megjithatë, sikurse rezulton nga vendimet e gjykatave të zakonshme, kërkuesi nuk ka paraqitur prova për gjendjen e tij ekonomike, përfshirë të ardhurat dhe pasurinë, por është kufizuar në pretendimin e përgjithshëm për papërballueshmërinë e tarifës gjyqësore për shkak të shumës së saj të konsiderueshme. Po ashtu, nuk rezulton që kërkuesi t'i jetë drejtuar Komisionit Shtetëror për Ndihmën Juridike me kërkesë për përjashtimin nga pagimi i taksës mbi aktet dhe as ai vetë nuk pretendon të ketë paraqitur një kërkesë të tillë. Gjykata e shkallës së parë e ka shqyrtuar kërkesën për përjashtim dhe e ka rrëzuar atë, duke arsyetuar se kërkuesi nuk kishte vërtetuar përmbushjen e kushteve ligjore për përjashtimin nga ky detyrim. Në vijim, ajo i ka caktuar kërkuesit afat për plotësimin e të metave të padisë dhe, pasi ka konstatuar se tarifa gjyqësore nuk ishte paguar, ka vendosur kthimin e padisë dhe të akteve të tjera. Ky vendim është

lënë në fuqi nga gjykata e apelit, ndërsa Gjykata e Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit të kërkuesit.

21. Në vlerësimin e Kolegjit, ndonëse tarifa gjyqësore prej 50.000 eurosh *prima facie* përbën një shumë të konsiderueshme, vetëm referimi te masa e saj, pa u mbështetur në të dhëna dhe prova konkrete për gjendjen ekonomike të kërkuesit, nuk mjafton për të vërtetuar se detyrimi për pagimin e saj i ka imponuar atij një barrë joproporcionale, duke cenuar thelbin e së drejtës së aksesit në gjykatë. Në këtë drejtim, Kolegji mban parasysh se kërkuesi kishte detyrimin të mbështeste me prova pamundësinë ekonomike të pretenduar, ndërsa gjykatat e zakonshme kishin detyrimin të vlerësonin këtë pretendim në përputhje me rrethanat dhe provat e paraqitura. Ndryshe nga rrethanat e çështjes *Laçi kundër Shqipërisë,* ku kërkuesi i ishte drejtuar Komisionit Shtetëror për Ndihmën Juridike dhe kishte paraqitur dokumentacion për gjendjen e tij ekonomike, i cili nuk ishte vlerësuar në mënyrën e duhur nga gjykata, në rastin konkret nuk rezulton që kërkuesi të ketë paraqitur kërkesë përpara këtij komisioni ose prova në mbështetje të pamundësisë ekonomike të pretenduar.

22. Në këto rrethana, Kolegji vëren se nuk rezulton që gjykatat e zakonshme të kenë shpërfillur ose refuzuar shqyrtimin e provave me rëndësi për vlerësimin e aftësisë së kërkuesit për të përballuar tarifën gjyqësore. Përkundrazi, ato kanë shqyrtuar kërkesën për përjashtim nga pagimi i tarifës gjyqësore dhe kanë arsyetuar rrëzimin e saj me mungesën e provave për përmbushjen e kushteve ligjore përkatëse. Për më tepër, kërkuesit i është dhënë afat për plotësimin e të metave të padisë, përpara se të vendosej kthimi i saj, por ai nuk e ka paguar tarifën gjyqësore dhe as ka paraqitur prova për pamundësinë ekonomike të pretenduar. Duke mbajtur parasysh kuadrin ligjor të zbatueshëm, mundësinë e përjashtimit nga pagimi i tarifës gjyqësore, sjelljen procedurale të kërkuesit dhe arsyetimin e gjykatave, Kolegji vlerëson se nuk rezulton që gjykatat e zakonshme t'i kenë interpretuar dhe zbatuar në mënyrë formaliste kërkesat procedurale ose t'i kenë imponuar kërkuesit një barrë joproporcionale, pra që të kenë cenuar të drejtën e tij të aksesit në gjykatë. Për rrjedhojë, pretendimi i kërkuesit për cenimin e kësaj të drejte është haptazi i pabazuar.

23. Për sa i përket kriterit të *shterimit të mjeteve juridike efektive,* Gjykata ka theksuar se individi mund t'i drejtohet asaj me ankim kushtetues individual vetëm pasi të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive për mbrojtjen e të drejtave kushtetuese që ai pretendon se i janë cenuar.

Mbrojtja kushtetuese ka një funksion subsidiar, që do të thotë se ajo mund të kërkohet vetëm pasi individi të ketë shteruar mjetet dhe rrugët e tjera ligjore. Ky rregull, në thelb, synon t'u japë organeve publike dhe në veçanti gjykatave të juridiksionit të zakonshëm mundësinë të parandalojnë ose korrigjojnë në substancë shkeljet e pretenduara të të drejtave kushtetuese të individit (*shih vendimet nr. 29, datë 16.04.2024; nr. 18, datë 19.03.2024; nr. 38, datë 02.12.2021 të Gjykatës Kushtetuese*).

24. Në lidhje me pretendimin për cenimin e *parimit të hierarkisë së normave dhe të lirisë së lëvizjes,* Kolegji vëren se ai lidhet me themelin e mosmarrëveshjes civile, konkretisht me ligjshmërinë e veprimeve të pretenduara penguese gjatë procedurës së pajisjes së kërkuesit me pasaportë biometrike. Megjithatë, gjykatat e zakonshme nuk janë shprehur për këto çështje, pasi procesi gjyqësor ka përfunduar me kthimin e padisë, për shkak të mospagimit të tarifës gjyqësore. Në këtë drejtim, duke mbajtur parasysh përfundimin e mësipërm se kthimi i padisë nuk rezulton të ketë cenuar të drejtën e aksesit në gjykatë, Kolegji vlerëson se mosshqyrtimi në themel i mosmarrëveshjes civile ka ardhur si pasojë e mosplotësimit nga kërkuesi të kërkesës procedurale për pagimin e tarifës gjyqësore, pa u provuar prej tij pamundësia ekonomike për përmbushjen e këtij detyrimi. Në këto kushte, për sa kohë pretendimet që lidhen me themelin e mosmarrëveshjes civile nuk kanë qenë objekt i shqyrtimit gjyqësor në substancë, Kolegji çmon se kërkuesi nuk e ka përmbushur kriterin e shterimit të mjeteve juridike efektive për këto pretendime, ndaj ato nuk mund të merren në shqyrtim.

25. Në përfundim, Kolegji çmon se ankimi kushtetues individual nuk plotëson kriteret ligjore të pranueshmërisë për kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pikat 1 dhe 2, shkronjat "d" dhe "e", të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.